



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.391, datë 21.10.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 55, DATË 28.10.2019 “PËR LICENCIMIN E SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME
ELBASAN”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 21.10.2021 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 55, datë 28.10.2019 "Për Licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Elbasan",

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Elbasan me shkresën nr.2217 prot. datë 26.07.2021, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik, me shkresën nr.2895 prot. datë 22.09.2021, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik dhe me shkresën nr.4515 prot. datë 28.09.2021, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a Ujësjiellës Kanalizime Elbasan" ka paraqitur pranë ERRU kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit..
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Elbasan për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.
3. **KKRR** ka licencuar shoqërinë UK Elbasan me vendimin nr. 55, datë 28.10.2019 "Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Elbasan", me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë

shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtues ligjor i shoqërisë UK Elbasan sh.a. z. Leli Kaja ka mbaruar studimet e larta në degën ekonomik dhe Juridik.
5. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Elbasan sh.a. znj. Lulzime Dama ka mbaruar studimet e larta në fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimi, në degën Ndërtim, profili Inxhinier për Ndërtime Civil – Industriale Ura, në vitin 1986.
6. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Elbasan sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Elbasan është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 55, datë 28.10.2019 “Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Elbasan”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues Ligjor Leli Kaja”

“Drejtues Teknik Lulzime Dama”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Ndriçim Shani